



REPUBLIKA E KOSOVES

REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIK OF KOSOVA

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Datë:	20.09.2017
Referencë:	
Për:	z. Zejnullah Gashi, Kryesues i Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel, Këshilli Prokurorial i Kosovës
Kopje	
Përmes	
Nga:	Nora Qerkezi, Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa
Lënda:	Raport për periudhën janar-qershor 2017

TAKIMET E KOMISIONIT PËR BUXHET, FINANCA DHE PERSONEL

Këshilli përmes vendimit KPK/Nr.54/2016 ka themeluar Komisionin Për Buxhet, Financa dhe Personel. Të gjitha veprimtarit që lidhen me planifikimin, shqyrtimin, rekomandimi, menaxhimin, implementimin dhe monitorimin e buxhetit të KPK-së, komisioni i kryen përmes Rregullores NR.05/2017.

Komisioni gjatë periudhës raportuese është takuar 4 herë, dhe atë për:

- Me datë 28 shkurt 2017 Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel ka mbajtur takim në të cilin është diskutuar për realizimin e buxhetit të vitit 2016.

- Me datë 17 maj 2017 Komisioni për Çështje Normative dhe Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel, kanë mbajtur takim të përbashkët, ku kanë diskutuar për Draft Rregulloren për Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel. Në këtë takim, përveç anëtarëve të dy komisioneve, kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit nga Ambasada amerikane, EULEX-i, dhe të projektit të binjakëzimit, të cilët në vazhdimësi mbështesin punën e Komisionit për Çështje Normative dhe të Këshillit në përgjithësi. Me datë 29 maj 2017 është miratuar rregullorja Nr.05/2017 për Komisionin për buxhet, financa dhe personel.

- Me datë 23 maj 2017 Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel ka mbajtur takim për rishikim të buxhetit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Me kërkesën për rishikim të buxhetit është kërkuar rritja e numrit të shërbyesve civil, si dhe rritja e buxhetit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve si dhe mallrave dhe shërbimeve.

- Me datë 5 qershor 2017 Komisioni për buxhet, financa dhe personel ka mbajtur takim lidhur me kërkesën e parë buxhetore për vitin 2018 si dhe vlerësimet e hershme 2019-2020. Me kërkesën e parë

buxhetore e cila është miratuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës është kërkuar rritja e numrit të shërbyesve civil, rritja e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve si dhe mallrave dhe shërbimeve.

SHPENZIMET, REALIZIMI I BUXHETIT SIPAS PROGRAMEVE DHE KATEGORIVE EKONOMIKE

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, Këshillit i janë ndarë 9,483,362.00€ , mjete të cilat janë të ndara në katër kategori ekonomike. Buxheti i vitit 2017 ka rritje të lehtë në krahasim me vitet paraprake, rritja në krahasim me vitin 2016 është rritur për 331,117.00€ ndërsa me vitin 2015 është rritur për 1,186,718.00€

Rritja buxhetore më së shumti vërehet në kategorinë e investimeve kapitale, në kategorinë e pagave si dhe kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Gjatë periudhës janar- qershor 2017 Këshilli ka realizuar 38.08% të buxhetit të aprovuar, ku në kategorinë e pagave dhe mëditjeve buxheti është realizuar 42.25%, mallra dhe shërbime 47.99%, shërbime komunale 26.80%, ndërsa në kategorinë e investimeve kapitale 0.0%.

Tabela 1. Paraqitja e buxhetit dhe realizimit për periudhën janar-qershor 2017

kategoritë ekonomike	Buxheti	Shpenzime janar-qershor
Paga dhe Mëditje	6 600 000,00	2,873,485.72
Mallra dhe Shërbime	1 426 552,00	737,102.80
Shërbime Komunale	199 630,00	53,504.35
Investime Kapitale	1 257 500,00	0,00
	9 483 682,00	3,664,092.87

KËRKESAT BUXHETORE

Mungesa e mjeteve buxhetore të ndara për vitin 2017 ka ndikuar negativisht që nga fillimi i vitit në kryerjen e detyrave në mënyrë sa më efikase në gjithë sistemin prokurorial.

Këshilli që nga fillimi i vitit i është drejtuar qeverisë me anë të kërkesa të veçanta dhe të rregullta për mjete shtesë buxhetore, dhe atë

1. **Korniza Afatmesme e Shpenzimeve**- Me 10 mars 2017 Këshilli ka dorëzuar kërkesën Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, ku ka paraqitur :misionin, situatën aktuale, objektivat dhe nga secila objektivi janë nxjerrë së paku dy deri tri aktivitete specifike ,trendët e financimit të dy viteve paraprake si dhe vlerësimet për dy vitet në vijim, si dhe politikat e reja – propozimet për politika të reja si:

- Rritja e numri të punëtorëve,*
- Rritja e mjeteve financiare në kategorinë e pagave dhe mëditjeve,*
- Rritja e mjeteve financiare në kategorinë mallra dhe Shërbime, si dhe*
- Rritja e mjeteve financiare në kategorinë Shpenzime Kapitale.*

2. **Kërkesa për rishikim të buxhetit** - Me datë 25.05.2017 Këshilli në qeveri ka paraqitur kërkesën për rishikim të buxhetit, me anë të së cilës ka kërkuar rritjen e numrit të personelit administrativ për 127 pozita në masë monetare prej 647,083.00€, si dhe mjete shtesë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në masë monetare prej 948,685.00€.

3 Kërkesa e parë buxhetore për vitin 2018 si dhe vlerësimet e hershme 2019-2020- Bazuar në Qarkoren 2018/01 Këshilli ka paraqitur kërkesën e parë buxhetore për vitin 2018 si dhe vlerësimet e hershme 2019-2020. Kërkesa e paraqitur nga Këshilli ka përfshi rritjen e numrit të personelit administrativ për 166 pozita, rritjen e masës monetare në kategorinë e pagave me vlerë prej 1,817,644.19€, rritja në kategorinë e mallrave dhe shërbime për 1,014,000.00€, si dhe rritjen në kategorinë e investimeve kapitale për 800,000.00€.

1.1 Kërkesat e veçanta

Me 19 janar 2017 Këshilli ka kërkuar mjete shtesë për përmbushjen e detyrimeve të cilat dalin nga marrëveshja e Brukselit për drejtësinë. Vlera totale e kërkuar është 253,150.79€. Kjo kërkesë ende nuk është aprovuar nga Qeveria.

Me 25 janar 2017 Këshilli ka kërkuar aprovimin e shtesave për prokurorë dhe personel të sistemit prokurorial. Vlera totale e kërkuar është 439,110.00€. Me datën 15.06.2017 Qeveria me vendimin nr.06/147 ka aprovuar pjesërisht kërkesën e Këshillit në shumë prej 185,077.92€,

Me datë 28.03.2017 Këshilli ka kërkuar rritjen e numrit të lejuar për personel administrativ (rritja për 129 personel administrativ shtesë) me masë monetare prej 682,378.76€, mjete shtesë për shtesa të prokurorëve të krimeve të rënda dhe të mitur me vlerë prej 185,077.92€, si dhe 889,000.00€ mjete shtesë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Deri më tani qeveria ka aprovuar vetëm shtesat e prokurorëve të krimeve të rënda dhe të mitur,

II. Raportimet

Bazuar në obligimet të cilat dalin nga Ligji për financa publike si dhe udhëzimit administrativ për raportime të organizatave buxhetore, divizioni për buxhet dhe financa gjatë periudhës janar- qershor 2017 ka raportuar si më poshtë:

- a. Me 27 janar 2017 është bërë barazimi me ministrinë e financave për vitin 2016 për të gjitha kategoritë ekonomike të Këshillit.
- b. Me 31 janar 2017 është dorëzuar raporti i pasqyrave financiare për vitin 2016.
- c. Me 16 shkurt 2017 është dorëzuar raporti lidhur me monitorimin e projekteve kapitale për vitin 2016
- d. Me 28 shkurt 2017 është dorëzuar pyetësori i vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2016.
- e. Me 7 prill 2017 është bërë barazimi me ministrinë e financave për tremujorin e parë të vitit 2017 për të gjitha kategoritë ekonomike të Këshillit.
- f. Bazuar në udhëzimin administrativ për raportim të obligimeve të organizatave buxhetore, divizioni për buxhet dhe financa raporton çdo muaj për të gjitha obligimet e sistemit prokurorial sipas kategorive ekonomike. Obligimet e fundit të cilat janë raportuar me 15 qershor kapinë vlerë totale prej 491,681.31€.

Vlen të ceket se obligimet e krijuara deri me 20.09.2017 janë 2,584 fatura me vlerë prej shumë prej 563,832.77€